



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.65/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët : Arsim Hamzaj kryesues, Skender Çoçaj dhe Kymete Kicaj, anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e Goran Marinković me vendbanim në Graçanicë , të parashtruar ndaj Milos Lazić nga subjekti politik “Srpska Lista” Graçanicë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore për Zgjedhjet Lokale, që do të mbahen më datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 26.09.2025, mori këtë :

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa ZL.Anr 65/2025, e datës 25.09.2025, e parashtruar nga Goran Marinković nga subjekti politik “Kosovski Savez” për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore për Zgjedhjet Lokale, që do të mbahen më datë 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Më datë 25.09.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesë ZL.Anr.65/2025 nga Goran Marinković nga subjekti politik “Kosovski Savez” me vendbanim në Graçanicë kundër Milos Lazić nga subjekti politik “Srpska Lista” Graçanicë, për shkak të kërcënimit me fjalë fyese, denigruese.

Parashtruesi i ankesës pretendon se më datë 24.09.2025, kandidati për asamble të Kuvendit Komunal në Graçanicë, nga subjekti politik “Srpska Lista”, kishte bërë një kërcënim me fjalë fyese, dukshëm i nervozuar dhe kishte filluar ta ofendonte “Nëse nuk tërhiqesh nga lista e kandidateve për asamble, unë do ta ndaloj hyrjen tënde në Republikën e Serbisë, ti këtu nuk paguan qira, unë do ta mbyll lokalin tënd dhe ti nuk do të punosh më. Por nëse tërhiqesh nga lista e “Kosovski Savez”, unë do të punësoj në ndonjë institucion.

Me tutje thekson se kur i kishte thënë se nuk do të tërhiqej nga lista , ai kishte filluar të bërtiste edhe me fort ndaj kandidatit, duke i thënë se ky do ta mbante mend dhe do të shihte se kush është Milos Lazić.

Në përgjigje në ankesë të datës 26.09.2025 thekson se: me 25.09.2025, Goran Marinković, në emër të subjektit politik “Kosovski Savez”, parashtrori ankesën Nr. 65/2025, në orën 14:20, në të cilën pretendon se Miloš Lazić i ka kërcënuar anëtarin e tyre Miljan Ničićin dhe ka kërkuar tërheqjen e tij nga lista e kandidatëve për asamblëistë të subjektit politik Kosovski Savez për Komunën e Graçanicës.

Kjo ankesë ka mangësi, është pa asnjë provë materiale dhe, sipas bindjes sonë të thellë, bazohet në motive të pasakta, të pavërteta dhe dashakeqe të ankuesit, i cili po përpiqet të keqpërdorë të drejtën për ankesë dhe të mashtrorë gjyqtarët e nderuar të këtij paneli me një histori që kufizohet me thashetheme fshati. Duke pasur parasysh se këto akuza janë shumë serioze, jemi të mendimit, dhe besojmë se ky është edhe qëndrimi i gjyqtarëve të këtij paneli, se ato duhet të mbështeten me prova serioze për fajësinë e personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, duke marrë parasysh seriozitetin e akuzave.

Në fillim duam të theksojmë se ankuesi, i cili e ka drejtuar këtë ankesë të paneli i nderuar për ankesa dhe parashtrës pa asnjë provë materiale, madje as pa deklaratë të z. Ničićit për ngjarjen e supozuar, i cili, siç pretendon ankuesi, i ishte ekspozuar presionit dhe kërcënimeve të supozuara nga Miloš Lazić. Pra, personi që gjoja ka marrë pjesë dhe për të cilin është referuar kërcënim i supozuar nuk ka bashkangjitur deklaratën e tij me të cilën do ta mbështeste ankesën e parashtruar nga z. Goran Marinković në emër të tij.

Deklarata e personit që ka pranuar në ankesën e tij se nuk është dëshmitar okular i ngjarjes sepse deklarata e tij mungon në ankesë, dhe i cili ka paraqitur ankesën, është joserioze dhe e rrezikshme, sepse me të keqpërdoret e drejta për ankesë si mjet ligjor që mbron rendin juridik dhe karakterin demokratik të zgjedhjeve.

Ankuesi përmend edhe ekzistencën e një farë incizimi, i cili nuk na është dorëzuar, dhe për të cilin nuk mundemi dhe nuk do të deklarohemi, sepse nuk dimë nëse ai ekziston vërtet, kur është bërë, në çfarë mënyre dhe nëse është bërë në përputhje me ligjin nga një person i autorizuar të incizojë persona të tjerë.

Lista Serbe, si subjekt politik i përgjegjshëm që merr pjesë në këto zgjedhje lokale, e zbaton fushatën e saj duke respektuar të gjitha rregulloret me qëllim që të japë kontributin maksimal në mënyrë që këto zgjedhje të jenë një festë e demokracisë me respektim të plotë të sundimit të ligjit. Prandaj, akuza të tilla të pabazuara duhet të hiqen qartë në mënyrë që të parandalohet keqpërdorimi i të drejtës për ankesë, e cila është një mjet i rëndësishëm për mbrojtjen e integritetit të procesit zgjedhor, dhe njëkohësisht të parandalohet vënia në dyshim e të gjithë procesit zgjedhor, e cila mund të lëkundë besimin e qytetarëve si në proces ashtu edhe në rezultatet e votimit, respektivisht rezultatet e procesit zgjedhor, në të cilin mijëra njerëz kanë bërë një përpjekje të madhe që ai të zhvillohet në përputhje me ligjin dhe parimet demokratike.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të ankesës të parashtruar nga ankuesi, vëren se është e pa bazuar. Paneli, pasi që shqyrtoi pretendimet ankimore konstatoi se:

- Ankesa është e pa bazuar

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës vlerësoj se pretendimet e subjektit politik “Kosovski Savez”, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7, të LZP-së, me të cilën përcaktohet: “*Kërcënimi ose tentimi për të kërcënuar subjektet tjera politike përkrahësit ose kandidatët e tyre*”, andaj si të tilla nuk kanë mundur të argumentohen me asnjë provë, pasi që pala ankuese nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, dhe në bazë të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin.

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës lidhur me shkeljen e pretenduar nga ana e subjektit politik “Kosovski Savez”, Paneli i vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin ndonjë nga shkeljet e pretenduara, kjo pasi që kandidati për asamble komunale nga subjekti politik “Kosovski Savez” në të cilën ka pretenduar se “*Nëse nuk tërhiqesh nga lista e kandidateve për asamble, unë do ta ndaloj hyrjen tënde në Republikën e Serbisë, ti këtu nuk paguan qira, unë do ta mbyll lokalit tënd dhe ti nuk do të punosh më. Por nëse tërhiqesh nga lista e “Kosovski Savez”, unë do të punësoj në ndonjë institucion*”, nuk ka ofruar dëshmi, andaj dhe në mungesë të provave nuk mund të vërtetohen pretendimet e tilla, për çka Paneli arrin në përfundim se pretendimet e parashtruesit nuk gjejnë mbështetje faktike apo juridike dhe rrjedhimisht, ankesa refuzohet si e pabazuar.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se “*Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesa dhe nga provat e ofruara si dëshmi nga parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj pretendimet e theksuara si më lartë se përbëjnë shkelje të kodit të mirësjelljes.

Sipas Panelit, Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politike të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit, dhe se çdo shkelje e këtij kodi ndëshkohet nëse të njëjtat argumentohen me prova nga pala ankuese.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar në nenin 117 par.3, lidhur me nenin 118 pa. 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZL.Anr.65/2025 datë 26.09.2025

Kryesues i Panelit,
Arsim Hamzaj



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.